



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.25/2018
Prishtinë, më 26.4.2018, në orën 12:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Hykmete Bajrami, Dardan Molliqaj, Memli Krasniqi dhe Bilall Sherifi, anëtarë.

Munguan: Mimoza Kusari – Lila, Gani Dreshaj dhe Duda Balje, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Etleva Malushaj – GDP dhe Alberta Hashani-KTV.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha- Shala, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12.4.2018;**
- 3. Shqyrtimi i Vendimit të Presidentit për kthimin e Ligjit nr.06/L-016 për shoqëritë tregtare;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12-20.4.2018

Dardan Sejdiu kërkoi që në procesverbal të dëgjohet transkripti deklarimi i z. Petrit Pepaj nga ZRRE-ja, në pjesën para rekomandimeve dhe të përmirësohet.

Procesverbali nga mbledhja e datës 12-20.4.2018, u miratua me plotësimin e dhënë nga z. Sejdiu.

3. Shqyrtimi i Vendimit të Presidentit për kthimin e Ligjit nr.06/L-016 për shoqëritë tregtare

Kryetarja i njoftoi anëtarët e komisionit së është dita e fundit në aspektin procedural që komisioni duhet ta shqyrtojë Vendimin e Presidentit për kthimin e Ligjit nr.06/L-016 për shoqëritë tregtare, për ta proceduar për shqyrtim në Kuvend. Ajo tha se siç jemi të njoftuar me arsyetimin vendimi është marrë nga Presidenti pasi që Oda Ekonomike e Kosovës, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë dhe shumë asociacione të bizneseve dhe vetë kompanitë, kanë shprehur shqetësimin e tyre të Presidenti i shtetit së ky nen i Ligjit për shoqëritë tregtare që ka të bëjë më kuotën gjinore në borde të shoqërive aksionare është shumë i vështirë për t'u zbatuar.

Dardan Sejdiu tha se arsyetimi i vendimit i Presidentit për Ligjin për shoqëritë tregtare nuk është i qëndrueshëm në asnjë parim kushtetues. Barazia para ligjit është e rregulluar në nenin 24 të Kushtetutës ku thuhet: Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato. Prandaj, kjo formë qysh e ka bërë arsyetimin Presidenti, propozoj që mos t'i bëjmë rekomandim Kuvendit për miratim të këtij vendimi.

Kryetarja tha se siç e dini amendamentin e znj. Kusari –Lila, Komisioni nuk e ka mbështetur si të tillë dhe arsyetimi i Presidentit është që të mos ketë diskriminim në bazë të ligjshmërisë.

Hykmete Bajrami tha se është e vërtetë se amendamenti i propozuar nga znj. Kusari- Lila, është dërguar në Kuvend në seancë plenare pa përkrahjen e komisionit, por që në seancën plenare është përkrahur nga deputetët dhe si i tillë ka kaluar. Andaj në këtë rast unë nuk do të votoj për, as kundër, por do të abstenoj. Ajo theksoi që është shqetësuese se Banka Botërore më 30 prill do ta ketë takimin e vet dhe do të marrë parasysh përmirësimin e të bërit biznes dhe

Kosova ka pasur progres në këtë drejtim në vitet e kaluara, por tani ende nuk ka hyrë në fuqi Ligji për shoqëritë tregtare dhe ekziston rreziku i zbritjes nga renditja e mirë që e kemi në të bërit biznes.

Dardan Molliqaj tha se mënyra se si e ka trajtuar Presidenti përfaqësimin e kuotës gjinore nëpër bordet e drejtorëve të shoqërive tregtare, nuk është korrekte dhe është joligjore. Ai theksoi se ka mjaftë praktika të vendeve Evropiane që e kanë të rregulluar mjaft mirë ruajtjen e kuotës gjinore në çdo përfaqësim, ndërsa kuota është e pranueshme nëpër përfaqësim të institucioneve pse mos të jetë edhe nëpër biznese. Prandaj, unë do të votoj kundër rekomandimit të Presidentit, pasi tashti kemi precedentin e përfaqësimit nëpër institucione të kuotës gjinore.

Bilall Sherifi tha se në këtë rast Presidenti e ka shfrytëzuar një të drejtë të tij kushtetuese, arsyetimi i tij është më shumë për njoftim, ndërsa, neve në komisionin, na mbetet vetëm ta votojmë për ta dërguar vendimin më rekomandim me shpjegim për shqyrtim në Kuvend. Ai theksoi së ligji kontestohet vetëm nëse dikush e konteston, por deputetët duhet ta kenë në tërësi lëndën për t' u njoftuar lidhur me procesin dhe procedurat për miratimin e një ligji.

Kryetarja tha se në nenin 61 të Rregullores së Punës së Kuvendit përcaktohet procedura e nënshkrimit dhe shpallja e ligjit si vijon: Ligji i miratuar nga Kuvendi nënshkruhet nga Kryetari i Kuvendit, në afat prej dhjetë ditë pune, nga dita e miratimit. Ligji i nënshkruar nga Kryetari i Kuvendit i dërgohet Presidentit të Republikës për shpallje. Nëse Presidenti i Republikës e kthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryesia e Kuvendit ia dërgon menjëherë Komisionit Funkcional raportues për shqyrtim. Komisioni Funkcional i shqyrton vetëm çështjet që i përmban vendimi i Presidentit. Komisioni brenda dy javë pune, nga data e pranimit të tij, Kuvendit ia paraqet raportin me rekomandime. Kuvendi me shumicën e votave të të gjithë deputetëve vendos për miratimin e rekomandimit të komisionit për vërejtjet e Presidentit, që me ndryshimet e miratuara, konsiderohet i shpallur. Nëse Kuvendi nuk e miraton rekomandimin e komisionit për vërejtjet e Presidentit, ligji mbetet ashtu siç është miratuar më parë nga Kuvendi dhe konsiderohet i shpallur. Nëse Presidenti i Republikës, brenda afatit të paraparë me ligj nuk e shpall ligjin ose nuk e kthen në Kuvend, ligji konsiderohet i shpallur dhe publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Dardan Molliqaj theksoi se thirrja e ime është që mos të pajtohemi më rekomandimin e Presidentit, por Komisioni ta dërgojë një rekomandim që nuk pajtohet më rekomandimin e Presidentit.

Memli Krasniqi tha se procedurat u sqaruan. Sa i përket amendamentit të propozuar ka qenë i dëmshëm për bizneset private dhe qëndrimi i tyre publik është që ky propozim të mos jetë pjesë e Ligjit. Ne duhet më proceduar për në Kuvend rekomandimin me vendim të Presidentit për ose kundër pastaj vendoset në seance për votim. Ai theksoi së debati për kuotën është temë që mund ta diskutojmë në përfaqësimin institucional por kushtëzimi është i padrejtë për kompaninë, mund ta komplikojë punën dhe biznesin e kompanive. Jemi që në forma të tjera të mbështesim kuotën gjinore.

Dardan Molliqaj tha se çështja e të drejtave të grave nuk është proces që duhet ta imponojmë sepse imponimet nuk funksionojnë. Më mirë është ta rregullojmë me përfaqësim të

përgjithshëm kuotën gjinore dhe shumica e organizatave shoqërore janë private, kufizimet që ju bëjnë janë sfidues.

Memli Krasniqi tha që rregullimin ekonomik e bëjnë vetë bizneset, nëse marrim vendim me ju imponuar kuota gjinore nuk është i mirë për shoqërinë dhe në veçanti për bizneset. Unë nuk besoj që ky propozim i fuqizon gratë.

Hykmete Bajrami tha që tentativa që t'i ndajmë përfaqësimet në institucione shtetërore dhe private nuk është e drejtë. Ajo theksoi së ka praktika ndërkombëtare ku është i rregulluar përfaqësimi i kuotave, por është i rregulluar në tërësi. Ne duhet me arritur nivelin e përgjithshëm të përfaqësimit.

Pas debatit, komisioni, me 4 (katër) për 2 (dy) kundër dhe 1 (një) abstenim, nxori këtë:

REKOMANDIM

Të miratohet Vendimi i Presidentit të Republikës së Kosovës, i datës 4.4.2018, që të fshihen dispozitat e Nenit 34, nënparagrafët 2.5.1.; 2.5.2.; 2.5.3. dhe 2.5.4, të Ligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare.

3. Të ndryshme Çështjet vijuese.

Kryetarja i njoftoi anëtarët e komisionit se ka pranuar ftesë nga Kryetarja e Kuvendit të Republikës së Bullgarisë z. Tsveta Karayancheva dhe nga Kryetari i Komisionit për Energji z. Delian Dobrev, për të marrë pjesë në takimin “Takimi i Kryetarëve të Komisioneve për Energji të Parlaenteve të Bashkimit Evropian” më 13-14 maj 2018 në Sofje, Bullgari. Delegacioni mund të jetë deri në pesë persona duke përfshirë, kryetarin e komisionit, deputetë, staf të komisionit dhe të tjerë.

Pas konsultimeve, komisioni, vendosi që në këtë takim të marrin pjesë: Sala Berisha-Shala, kryetare e komisionit, Hykmete Bajrami, Memli Krasniqi dhe Bilall Sherifi - anëtarë të komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA